



Pranimi / Dorezimi Prilazje / Protokol Received / Delivery		22.02.2021		1 viti god year
Organ / Rrjeta Organ / Jednica Org. Unit	Br. Prot. Pr. No.	Shtypja Protog. Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHICK	737/2021		1/6	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.06/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses për shqyrtimin e ankesës A. Nr.06/2021 të datës 08.01.2021 kanë shqyrtuar ankesën e parashtruar nga ankuesja me adresë: Rruga "Uran Ajeti", banesat e Maringut, Lagja e Spitalit, në Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike "*masë disiplinore-vërejtje me shkrim*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 22.02.2021 mori këtë

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.06/2021 e datës 08.01.2021 e parashtruar nga ankuesja

II. MBETET në fuqi Vërejtja me shkrim me numër protokollit 5058 e datës 11.12.2020, lëshuar nga Drejtoresha e Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

A r s y e t i m

Ndaj ankueses [Blank] e punësuar në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, sipas akt emërimit Nr.4569 të datës 15.11.2019, në pozitë „Udhëheqëse e Divizionit për Integritet Evropian“, në Departamentin për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, me datë 11.12.2020 Mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë-Drejtoresha e Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, i ka shqyrtuar vërejtje me shkrim me numër protokollit 5058, për shkak të sjelljeve jo profesionale, në raport me mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë dhe me stafin e saj vartës, gjatë kryerjes së detyrave të punës dhe përgjegjësisive të saj. Ankuesja në takimin e datës 04.12.2020, të mbajtur në zyrën e Drejtoreshës së Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, është grindur me mbikëqyrësen e drejtpërdrejtë dhe për shkak sjelljes jo profesionale takimi është ndërpre dhe nuk është arritur qëllimi i tij, për të sqaruar arsyen e mos vlerësimit të punës provuese, për nëpunësen [Blank] nga ankuesja

Ankuesja e pa kënaqur me shqiptimin e vërejtjes me shkrim, ka parashtruar ankesë me datë 08.01.2021 me numër protokoll 44/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore se vërejtja me shkrim është e pabazuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 13.01.2021, e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Më datë 22.01.2021 dhe me datë 29.01.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 44/2021 të datës 08.01.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtja me shkrim me numër protokoll 5058 e datës 11.12.2020; Përgjigje për komente i datës 11.02.2016; Plani individual vjetor i punës 2020; Raporti punës për periudhën janar-dhjetor 2020; E-mail i datës 09.10.2020; E-mail i datës 24.09.2020; E-mail i datës 26.10.2020; E-mail i datës 20.10.2020; E-mail i datës 01.12.2020; E-mail i datës 15.12.2020; E-mail i datës 16.11.2020; E-mail i datës 11.11.2020; E-mail i datës 10.11.2020; E-mail i datës 04.11.2020; E-mail i datës 17.11.2020; Formulari për vlerësimin e punës provuese 2020; E-mail i datës 23.01.2020; E-mail i datës 31.03.2020; E-mail i datës 04.06.2020; E-mail i datës 28.10.2020; E-mail i datës 31.08.2020; E-mail i datës 19.08.2020; E-mail i datës 18.08.2020; E-mail i datës 13.08.2020; E-mail i datës 04.09.2020; E-mail i datës 31.08.2020; E-mail i datës 28.08.2020; E-mail i datës 26.08.2020; E-mail i datës 20.08.2020; E-mail i datës 17.08.2020; Formulari për vlerësimin e punës provuese i datës 22.02.2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 14.12.2018; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 19.12.2019; Përgjigje në ankesë në adresë elektronike e datës 22.01.2021 dhe e datës 29.01.2021; Përgjigje në ankesë e datës 29.01.2021 me numër protokoll 350/2021; Akte emërim i datës 15.11.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 25.01.2021; Kthim i përgjigjes në ankesë i datës 28.01.2021; E-mail i datës 21.01.2021; E-mail i datës 31.08.2020; E-mail i datës 22.01.2020; E-mail i datës 02.03.2020; E-mail i datës 03.03.2020; E-mail i datës 27.01.2020; E-mail i datës 23.01.2020; E-mail i datës 26.01.2021; E-mail i datës 26.01.2021 FT; E-mail i datës 12.03.2020; E-mail i datës 29.04.2020; E-mail i datës 30.04.2020; Vendimi i datës 27.07.2020 për transferim të përhershëm; E-mail i datës 26.01.2021 FM; E-mail i datës 10.02.2020; E-mail i datës 13.04.2020; E-mail i datës 19.04.2020; E-mail i datës 31.04.2020; E-mail i datës 04.09.2020; E-mail i datës 13.01.2021; E-mail i datës 30.12.2020; Kërkesë e datës 15.01.2021; Vendim Nr.93/2 i datë 19.01.2021; Përgjigje e datës 22.01.2021 në ankesë në formë elektronike me numër protokoll 279/2021 dhe E-maili i datës 10.02.2021, i datës 11.02.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pabazuar sepse,*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses kundër vërejtjes me shkrim të datës 11.12.2020 me numër protokoll 5058, nga Mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankueses, e cila pretendon se është në kundërshtim me ligjin në fuqi, sepse nuk është konstatuar drejtë gjendja faktike dhe juridike .

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të shqyrtimit të provave të lëndës ka konstatuar se pretendimet e ankueses janë të pa bazuara sepse, Mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë/Drejtoresha e Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me rastin e shqiptimit të vërejtjes me shkrim të datës 11.12.2020, i ka shqiptuar vërejtje të lehtë, për shkak të sjelljeve jo profesionale, të përsëritur në raport me mbikëqyrësen e saj të drejtpërdrejtë dhe me stafin vartës, gjatë kryerjes së detyrave të punës dhe përgjegjësi të saj, sepse nëpunësja civile ka kryer shkelje disiplinore të lehtë, të përcaktuar në nenin 46 paragrafin 1

paragrafin 2 nën paragrafin 2.1 dhe paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, ku përcakton se: *''Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore.2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.2. shkelje të lehta''*, paragrafi 4. *''Shkelje të lehta konsiderohen: 4.2. shkelja e rregullave të etikës''*, shqiptimi i vërejtjes së lehtë është nxjerrë në bazë të kompetencës së saj të përcaktuar në nenin 48 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, ku përcakton se: *''Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë''*, lidhur me neni 4 paragrafin 1 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve publik, ku përcaktohet se: *''1. Procedura disiplinore përfshin procedurën administrative, që kryhet nga marrja në dijeni për një shkelje disiplinore, deri në marrjen e një mase disiplinore nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.....''*, e cila rregullore është aprovuar me datës 21.08.2020 nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që specifikon procedurat disiplinore dhe kompetencat e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, të nëpunësve civil, në pajtim Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për të konstatuar gjendjen faktike dhe bazën juridike. me datën 13.01.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Menaxherja e personelit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për përgjigje në ankesën e parashtruar nga ankuesja e cila me datë 21.01.2021 për mes E-mailit e ka përcjellë krekës tek Drejtoresha e Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, për kompletimin e lëndës pasi që vërejtja me shkrim është lëshuar nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankueses dhe me datë 28.01.2021 e njëjta e ka përcjellë përgjigjen në ankesë me numër protokollit 319, përmes Menaxheres së personelit të Ministrisë, me shkresat bashkangjitura me datë 29.01.2021 me numër protokollit 350/2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka administruar provat e lëndës ka konstatuar se Menaxherja e Personelit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në bazë të pamundësisë së kompletimit të dhënave rreth vlerësimit të periudhës provuese të nëpunës nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë me datë 03.12.2020 ka kërkuar takim zyrtar nga Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, i cili takim është realizuar me datë 04.12.2020 në zyre të Drejtoreshës së Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, si mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e ankueses, në të cilin takim kanë qenë prezent ankuesja, mbikëqyrësja e asaj, Menaxherja e personelit dhe nëpunësja znj.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se vërejtja me shkrim e shqiptuar me datës 11.12.2020 nga Mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë / Drejtoresha e Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, ndaj ankueses, është si rrjedhojë e takimit të datës 04.12.2020 i cili takim është ndërpre për shkak se ankuesja në takimin e realizuar në zyrën e mbikëqyrëses së saj, është grindur direkt me znj. dhe për shkak të kësaj sjellje, është ndërpre takimi si dhe nuk është arritur qëllimi i tij, për të sqaruar arsyen e mos vlerësimit të punës provuese, për nëpunësen nga mbikëqyrësja e saj Mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankueses ka theksuar se sjelljet e ankueses janë të njëjta të pa ndryshueshme jo profesionale, siç ka ndodh dhe në takimet e tjera me stafin në fillim të vitit 2020 (në takimin e datës 11.02.2020), për të vërtetuar këtë Drejtoresha e Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, pasi ka pranuar ankesën e ankueses nga Njësia e personelit, për t'ju përgjigjur Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.01.2021 ka kërkuar deklarata nga nëpunësit civilë të këtij Departamenti, për të deklaruar lidhur me takimet e stafit pse ka pasur mungesë të procesverbalit. Të cilat me datë 26.01.2021 kanë deklaruar përmes E-mailit zyrtar, znj. -Zyrtare e Integritet Evropian 2, znj.F.Tahiri-Shefe e Divizionit për Koordinimin e Politikave si dhe Menaxherja e personelit, deklaratat citohen, si në vijim: deklarata e znj. Zyrtare e Integritet Evropian 2, citoj: *''.....deklaroj që shumica e takimeve të stafit, janë degraduar deri në shkallë të ofendimeve dhe kërcënimeve nga (sidomos ajo e*

datës 11.02.2020)...që nuk është etike të citoj decidivisht se çka ka thënë dhe çka është diskutuar, këtë më së miri e tregon fakti që unë dhe Shefe e Divizionit për KP, jemi detyruar ta lëshojmë takimin, në mënyrë që ti shmangemi konfliktit verbal me zonjën e cila ka tentuar të na përfshijë në debat për tema të cilat nuk janë dhe nuk duhet të jenë pjesë e një bashkëbisedimi zyrtar. e them me siguri të plotë që nuk keni qenë ju ajo që keni iniciuar një zënkë të tillë, të dërguar deri në shkallë kërcënimesh. , ka kohë që ka pasur një sjellje arrogante dhe ndaj meje..... jam vlerësuar negativisht për periudhën provuese,si dhe jam detyruar të kërkoj ndërrimin e divizionit,.....duke tentuar të cenojë integritetin tim profesional.

Deklarata e znj. Shefe e Divizionit për Koordinimin e Politikave, citoj:”.....Ndërsa në takimin e datës 11.12.2020 pas raporteve të punës nga ne, ka filluar me ofendime dhe shpifje që nuk përkojnë me sjelljet zyrtare. gjë që në këtë takim unë dhe Arnesa Zyrtare për Integritet Evropiane, jemi detyruar të lëshojmë takimin, vetëm dhe vetëm për t'ju shmangur debateve konfliktuoze. Gjendja ka vazhduar të tensionohet gjatë muajve në vazhdim dhe si rrjedhojë e kësaj unë e kam lëshuar zyrën, duke tentuar në këtë mënyrë të kem një ambient të përshtatshëm të punës, për të përmbushur obligimet dhe aktivitetet e mia të punës”.

Deklarata e znj. Menaxherja e personelit”.....takimi i mbajtur nga ana ime ka pasur qëllim lidhur me mos pajtime e DIEKP rreth vlerësimit të punës për periudhën provuese për zyrtaren nga mbikëqyrësja Janë diskutuar temat rreth vlerësimit, pakënaqësive, ndërsa saj përket fjalëvenuk i kam dëgjuar sepse nuk kemi qëndruar shumë gjatë unë dhe që njëkohësisht e kam lutur të kthehet në zyrë e saj dhe nuk është pajtuar. Mes ju dhe 'a vazhduar diskutimi që nuk jam përgjegjëse për çka keni diskutuar”.

Bazuar në deklaratimet e nëpunësve civil, të Departamentit për Integritet Evropiane dhe Koordinim të Politikave, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se deklaratat e tri (3) nëpunësve, kanë vërtetuar gjendjen faktike, lidhur me shqiptimin e vërejtjes me shkrim të datës 11.12.2020, e shqiptuar ndaj ankueses, nga Mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se në bazë të komunikimit zyrtar (E-mailave) të datës 16.11.2020, në mes të ankueses, Mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë dhe Menaxheres së personelit si dhe nëpunësve civile znj është vërtetuar se ankuesja, nuk i ka bërë vlerësimin e punës provuese nëpunësve civile për periudhën nga janari deri në muajin korrik të vitit 2020, me arsyetimin se është e anashkaluar nga nëpunësja civile, nuk ka respektuar hierarkinë dhe nuk i ka kryer detyrat e punës të cilat i janë kërkuar nëpunësve. Lidhur me këtë arsyetim është vërtetuar se ankuesja nuk ka dëshmi të bazuar për mos kryerjen e detyrave të punës nga nëpunësja, dhe se pretendimi është i pa bazuar për faktin se, në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesja nga data 12.03.2020 deri në muajin qershor 2020, ka qenë e liruar nga puna me qëllim të përkujdesjes së fëmijët sipas Vendimit të Qeverisë për parandalimin e infektimit me CV-19, të cilin fakt e vërteton dhe vetë ankuesja në E-mailin e datës 12.03.2020, (...jam e liruar nga puna për përkujdesje të fëmijut...). Andaj, lidhur me këtë, në mungesë të ankueses është konfirmuar se nëpunësja civile znj ka qenë në mbikëqyrje të Drejtoreshës së Departamentit për Integritet Evropiane dhe Koordinim të Politikave, znj. sipas komunikimi zyrtar të datës 31.03.2020, ku ankuesja ka udhëzuar nëpunësen znj që të bashkëpunojë me personat përgjegjës për kryerjen e punëve të Divizionit.

Në bazë të provave të lëndës, deklaratës së datës 26.01.2021 të nëpunësve civile znj dhe znj të cilat janë deklaruar lidhur me ekzistimin e sjelljeve të pa hijshme të vazhdueshme dhe jo zyrtare nga ana e ankueses dhe si rrjedhojë e këtyre sjelljeve nëpunësja civile znj e punësuar në Divizionin për Integritet Evropiane, sipas Akte emërimit të datës 05.12.2019, me datë 15.01.2020 ka kërkuar transferim në një divizion tjetër, i cili transferim është realizuar, me datë 24.07.2020 nga Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe

Zhvillimit Rural, i cili ka nxjerrë Vendimin Nr.2989 ku znj. _____ e ka transferuar përkohësisht në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në pozitë të shërbimit civil të së njëjtës kategori, duke vepruar në pajtim me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, nga data 27.07.2020 deri në marrjen e një vendimi tjetër.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka administruar provat e lëndës nga të dy palët, ka konstatuar se ankuesja nuk ka zbatuar në tërësi urdhrat e marra nga mbikëqyrësja e saj e drejtpërdrejtë, siç e përcakton dispozita ligjore e nenit 26 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, ku përcakton se: ***''Zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit''***, duke u bazuar në gjendjen faktike dhe bazën juridike, të bazuar në shkresat e lëndës komunikimit zyrtar, në mes të ankueses dhe mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë znj. _____ në veçantin komunikimi zyrtar të datës 24.09.2020, ku nga ankuesja është kërkuar që të kryej detyrën në kuadër të DIEKP- tabelat e përputhshmërisë, sipas kërkesës së Sekretarit i Përgjithshëm, që në rastin konkret ankuesja nuk ka ofruar asnjë dëshmi se i ka përfunduar detyrat e punës lidhur me kërkesat apo urdhrin e mbikëqyrëses, po ashtu dhe duke u bazuar në korrespondencën zyrtare të datës 13.08.2020, të datës 18.08.2020, të datës 19.08.2020, të datës 28.08.2020 dhe të datës 31.08.2020, ndërlidhur dhe me E-mailin e datës e 30.04.2020, si dhe komunikimet e tjera të muajit mars 2020. Këtë e dëshmon dhe formulari i vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020, e cila është vlerësuar me notën e përgjithshme 1.9, me datë 25.01.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se vërejtja me shkrim e shqiptuar e datës 11.12.2020, ndaj ankueses _____ është nxjerrë nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankueses, për shkak se ankuesja nuk ka zbatuar rregullat ligjore gjatë kryerjes se detyrave të punës për mbrojtjen e interesit të shtetit dhe të drejtave të njeriut, të bazuar në nenin 25 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, ku përcakton se: ***''2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike''***.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se ankuesja _____ për veprimet dhe mos veprimet e saj, lidhur me përgjegjësit në punë si „Udhëheqëse e Divizionit për Integritet Evropiane'', në Departamentin për Integritet Evropiane dhe Koordinim të Politikave, ka vepruar në kundërshtim me nenin 28, të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, ku përcakton se: ***''Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij''***.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar provat e lëndës veç e veç të ankueses dhe organit të punësimit ka konstatuar se Mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë / Drejtoresha e Departamentit për Integritet Evropiane dhe Koordinim të Politikave, në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me rastin e shqiptimit të vërejtjes me shkrim të datës 11.12.2020 me numër protokollit ndaj ankuesit _____ ka vepruar në pajtim me parimet e individualizimit të masave disiplinore të bazuar në nenin 50 paragrafin 1, nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.4 dhe paragrafin 2 dhe paragrafin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, ku përcakton se: ***''1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit. 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer. 4. Për shkeljet e lehta, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji''***

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.06/2021



Zyle Millaku GOJNOVCI
proçesmbajtëse

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Menaxherit të Personelit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.